



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2019:212662

Datë: 03.10.2022

Numri i dokumentit: 03485754

P.nr.376/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari Burim Çaka, procesmbajtësja Suzane Rudi, në çështjen penale kundër të akuzuarës M.A nga Kumanova Republika e Maqedonisë Veriore, për shkak të veprës penale Falsifikim i dokumentit nga neni 390 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj me numër PP/II.nr.1607-4/2019 të datës 19.09.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik më datë 19.09.2022 në praninë e Prokurores së Shtetit Mimoza Sylja Hyseni, të akuzuarës dhe mbrojtësit të sajë - Avokat A. S., më datë 21.09.2022 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 03.10.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E akuzuara: M.A nga Kumanova Rr. “...” nr..., e lindur më datë ..., nga i ati K... dhe e ëma V... e gjinisë J..., me numër personal ..., beqare, ka të kryer shkollën e mesme, punon në butik “...”, e gjendjes së mesme ekonomike, maqedonase, shtetase e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e pa gjykuar më parë, mbrohet në liri.

Në bazë të nenit 364, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP)

LIROHET NGA AKUZA

Sepse më datë 22.07.2019, rreth orës 15:30, në pikën kufitare Hani i Elezit Republikë e Kosovës – Republika e Maqedonisë Veriore, saktësisht në linjën dalëse të kontrollimit të veturave, e pandehura me e sajë, me ngjyrë të kuqe, me targa ..., duke e kaluar pikën kufitare i ka prezantuar dokumentet e nevojshme policit kufitar, ku në mesin e dokumenteve ka prezantuar edhe dokumentin e falsifikuar – kartonin e gjelbër me numër MK/... të automjetit, ku nga raporti i ekspertimit AKF/2019-2020 i datës 05.09.2019, konstatohet se dokumenti është falsifikim i plotë.

- Me të cilat veprime do të kryente veprën penale Falsifikim i dokumentit nga neni 390 paragrafi 1 të KPRK-së.

- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1607-4/2019 të datës 19.09.2019, kundër të akuzuarës së lartë shënuar për shkak të veprës penale Falsifikim i dokumentit nga neni 390 paragrafi 1 të KPRK-së dhe ka kërkuar që e njëjta të shpallet fajtores dhe të dënohet sipas ligjit.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor

Prokuroria e Shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe fjalës përfundimtare ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale ku, pas administrimit të provave në këtë shqyrtim gjyqësor ku si prova materiale, raporti i oficerit i datën 22.07.2019, raporti i ekspertimit i datës 09.08.2019, të lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë vërtetimi mbi konfiskim, si dhe pas dëgjimit të ekspertes nga Agjencioni i Kosovës për Forenzikë V. M. u vërtetua gjendja faktike sikurse në aktakuzë, i ka propozuar gjykatës që të pandehurën ta shpallë fajtores dhe ti shqiptoj sanksion penale të paraparë me ligj.

- Mbrojtësi i të akuzuarës gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe fjalës përfundimtare ka deklaruar se kjo aktakuzës nuk e ka përmbushur detyrimin kryesorë të paraparë në nenin 7 të KPP-se, me qe nëse palët se marrin pjesë në procedurë kanë për detyrim ti vërtetojnë faktet që janë të rëndësishme për marrjen e një vendimi të ligjshëm. 1. Është ngritur aktakuzës pa e marrë farë në pyetje të akuzuarën për akuzën për të cilën ajo akuzohet, nuk ju ka mundur që e njëjta të paraqet mbrojtjen e vet, ti paraqet faktet që do ta shfaqësonin nga një akuzë. Në deklaratën e datën 10.07.2019, për të cilën unë mendoj se data është gabim, qartazi në këtë deklaratë e mbrojtura ime ka dhënë vetëm informatat gjenerale dhe ka deklarua që nuk dëshiron të deklarohet për rastin në këtë fazë, menjëherë pas dy dite nga Prokuroria është kërkuar memorandumi zyrtar dhe pas pesë ditë është dërguar shkresa në Agjencionin e Kosovës për Forenzikë, dhe menjëherë ka pësuar akuza pa u marrë në pyetje e akuzuara, prandaj konsiderojmë që kjo akuzë duhet të hudhet realisht refuzohet nga ana e Gjykatës, si e pa bazuar. Nuk ka asnjë provë tjetër që mund ta inkrimoj drejt për drejt të akuzuarën qoftë që e njëjta ka përdor apo ka prodhuar apo ka qenë në dijeni që një dokument mund të jetë i falsifikuar dhe që e njëjta më atë dokument të hy në territorin e Kosovës për të shkaktuar veprë penale, madje pas verifikimit që ky dokument i përmban të gjitha procedurat dhe është në përputhje me vlefshmërinë e kartonëve të gjelbër pasi që Prokuroria ka kuptuar ose e ka marrë informatën nga organi që e ka lëshuar këtë dokument konsiderojmë që të paktën është dashtë edhe një herë, të zhvilloj hetime me që tani kemi një organi një institucion që po deklaron që dokumentin për të cilin ju si Prokurori po pretendoni se e akuzuara e ka prodhuar e ka falsifikuar dhe e ka përdor është lëshuar nga ata automatikisht tani më dihet në rast se Prokuroria prapë mendon se i njëjti është i falsifikuar tani ka adresën se ku mund të jetë falsifikuar. Dhe mbi këtë bazë automatikisht konsiderohet që ë mbrojtura ime ti ketë marrë veprimet të cilat janë prezantuar ne aktakuze dhe po ashtu edhe elementet që i parasheh vepra penale nga nenin 390, nëse kësaj ja shtojmë që ky dokument nuk është fare në emrin e sajë atëherë mosekzistimi i hetimeve këtë akuzë e bënë të pa besueshme dhe si e tillë Gjykata duhet ta refuzoj me që asnjë provë nuk ekziston që ju referohet personalisht të akuzuarës, kartoni i gjelbër nuk është në emër të saj që dmth nuk është nxjerr apo blerë nga ajo dhe tjera Byroja ka pranuar vërtetësinë- autotencitetin e saj, andaj pos me një provë të mund të akuzohet apo dënohet dikush, mirëpo në rastin konkret nuk kemi asnjë provë të vetme të M.A, e po ashtu ajo çka është më me rëndësi e njëjta asnjëherë nuk është deklaruar për akuzën për të cilën është bërë.

E akuzuara gjatës shqyrtimit gjyqësor dhe fjalës përfundimtare e ka mohuar në tërësi kryerjen e veprës penale dhe i ka mbështetur fjalët e mbrojtësit të sajë.

Provat e administruara gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor

Është dëgjuar në cilësinë e ekspertës V. M. nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, u shikua kartoni i gjelbër, u lexua raporti fillestar i incidentit i datës 22.07.2019, raporti i oficerit M. A. i datës 22.07.2019, procesverbal mbi marrjen në pyetje të pandehurës e dhënë në Stacionin Policor Hani i Elezit e datës 10.07.2019, raport të ekspertimit të lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me numër AKF/2019-2020/2019-1788 e datës 09.08.2019, formular i konfiskimit të dokumentit i datës 22.07.2019, dy fletë me fotografi të kartonit të gjelbër, fletë me gjurmët e gishtave të të pandehurës, Vërtetimi mbi vlefshmërinë e kartoni të gjelbër për veturën ..., të lëshuar nga Byroja Kombëtare për sigurime e Republikës së Maqedonisë, në gjuhën maqedone dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.

Pa pyetje dhe me vërejtje nga ana e mbrojtësit të të akuzuarës në raportin e thjeshtë të oficerit, i cili ka deklaruar e nuk paraqet prova ajo se pse është vetëm raport, po ashtu deklarata që ju referohet të pandehurës është vetëm dhënia e informatave gjenerale dhe asnjëherë nuk ka dhënë deklaratë për rastin për të cilën është akuzuar. Po ashtu kemi vërejtje edhe në raportin e forenzikës, me që i njëjti i mungon dokumenti krahasues i lëshuar nga organi përkatës, dokumentin të cilin e ka shfrytëzuar për krahasim është i përafërt siç edhe është deklaruar ekspertja.

Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet

Gjykata ka analizuar dhe vlerësuar një nga një dhe të gjitha bashkërisht të gjitha provat që janë administruar gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor, ku pas analizimit të të gjitha këtyre provave, ka ardhur në përfundim se nuk është provuar se e ka kryer veprën penale Falsifikim i dokumentit nga neni 390 paragrafi 1 të KPRK–së duke u bazuar në këto fakte vendimtare të provuara:

Gjykata vlerëson se për tu kryer vepra penale Falsifikim i dokumentit nga neni 390 paragrafi 1 të KPRK–së, kryerësi duhet që veprën penale ta kryej me dashje direkte.

Gjykata vlerëson se nga provat të cilat janë administruar në shqyrtim gjyqësor janë vërtetuar këto fakte vendimtare:

Sigurimi kufitar – kartoni i gjelbër i MKD –së me numër serik MK/..., përkundër cilësisë së letrës në të cilën ka qenë i shtypur, përmbajtja ka qenë origjinale dhe i lëshuar në mënyrë të rregullt kjo vërtetohet nga:

- Dokumenti i lëshuar në gjuhën maqedone nga Byroja Kombëtare për Sigurim e Republikës së Maqedonisë Veriore e datës 31.03.2021 me numër 0809-911-/1-2021 i përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyesja ligjore – V. J., me të cilin vërtetohet se kartoni i gjelbër me numër MK/... është lëshuar nga sistemi qendror i Byroja Kombëtare për Sigurim e Republikës së Maqedonisë Veriore në emër të personit A. M. me periudhë vlefshmërie të kartonit të gjelbër nga data 19.06.2019 deri më 29.12.2019. Po ashtu nga ky njoftim është konstatuar edhe një fakt vendimtar, ku theksohet në njoftim citoj “Kartoni i gjelbër i lëshuar është në pajtueshmëri me procedurat dhe proceset për dhënie dhe vlefshmëri të kartonëve të gjelbër në Republikën e Maqedonisë Veriore.

Provën - Dokumenti i lëshuar në gjuhën maqedone nga Byroja Kombëtare për Sigurim e Republikës së Maqedonisë Veriore e datës 31.03.2021 me numër 0809-911-/1-2021 i përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyesja ligjore – V. J., gjykatës ia ka prezantuar mbrojtja e të akuzuarit së bashku me kërkesën për hudhjen e aktakuzës. E njëjta është administruar në shqyrtim gjyqësor dhe lidhur me këtë provë nuk ka pasur ndonjë vërejte nga Prokuroria e Shtetit. Këtë provë gjykata e vlerësoi si të besueshme.

Po ashtu Gjykata ka vlerësuar se e akuzuara në momentin e kalimit të kufirit Republika e Maqedonisë së Veriut – Republikë e Kosovës në pikën kufitare, vetura ... me ngjyrë të kuqe me targa ... ka qenë e motrës së sajë – M. A., me qenëse vetura ishte në emër të motrës së të akuzuarës, po ashtu edhe kartoni i gjelbër ishte në emër të M. A. – motrës së të akuzuarës.

Gjykata i analizoi edhe provat tjera të propozuar nga Prokuroria e shtetit në aktakuzë, si:

Raport të ekspertimit të lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë me numër AKF/2019-2020/2019-1788 e datës 09.08.2019 dhe dëgjimin në cilësinë e ekspertës V. M. nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë.

Nga kjo provë Gjykata nxjerri përfundimin se letra, cilësia e letrës, mënyra e printimit në kartoni i gjelbër i MKD –së me numër serik MK/... nuk kanë qenë në cilësinë e letrës së kërkuar, mënyrës standarde të printimit, dhe si të tillë gjykata e vlerësoi të besueshme, por përmbajtja në letër ka qenë origjinale dhe e lëshuar në mënyrë të rregullt, fakt të cilin gjykata e ka vërtetuar nga dokumenti i lëshuar në gjuhën maqedone nga Byroja Kombëtare për Sigurim e Republikës së Maqedonisë Veriore e datës 31.03.2021 me numër 0809-911-/1-2021 i përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyesja ligjore – V. J., e po ashtu si në raportin për ekspertim edhe në seancë gjyqësore nga ekspertja e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë nuk kanë dhënë ndonjë të dhënë apo përfundim lidhur me përmbajtjen e dokumentit në fjalë.

Gjykata ka vlerësuar se akuzuara, në rastin konkret apo motra e të akuzuarës në emër të së cilës është kartoni i gjelbër, nuk kanë mundur ta dijnë se në çfarë letre apo çfarë cilësie apo mënyrë duhet të shtypet kartoni i gjelbër nga shitësi, sepse e njëjta është blerë në mënyrë të rregullt, të cilin fakt gjykata e ka vërtetuar nga dokumenti i lëshuar në gjuhën maqedone nga Byroja Kombëtare për Sigurim e Republikës së Maqedonisë Veriore e datës 31.03.2021 me numër 0809-911-/1-2021 i përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyesja ligjore – V. J., e me këtë provë po ashtu vërtetohet se nuk ka qenë dashja e të akuzuarës për ta kryer këtë vepër penale.

Nga provat tjera të administruara si, raporti fillestar i incidentit i datës 22.07.2019, raporti i oficerit M. A. i datës 22.07.2019, procesverbal mbi marrjen në pyetje të pandehurës e dhënë në Stacionin Policor Hani i Elezit e datës 10.07.2019, formular i konfiskimit të dokumentit i datës 22.07.2019, dy fletë me fotografi të kartonit të gjelbër, fletë me gjurmët e gishtave të të pandehurës, nuk është arritur të vërtetohet ndonjë fakt me rëndësi vendimtare, përpos mënyrës se si është zhvilluar procedura lidhur me dyshimin për falsifikim të kartonit të gjelbër.

Gjykata me rastin e vendosjes po ashtu në këtë rast ka pasur parasysh edhe parimin in dubio pro reo.

Baza ligjore.

Gjykata duke u bazuar në nenin 364 pika 1.3 të KPP-së ka vërtetuar se nuk është provuar se e akuzuara ka kryer veprën penale Falsifikim i dokumentit nga neni 390 paragrafi 1 të KPRK-së

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Të njëjtat bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate konform nenit 454 par 1 të KPP-së.

Andaj duke u bazuar në të gjitha të cekurat më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr.376/19, datë 03.10.2022

Procesmbajtësja

Suzane Rudi

Gjyqtari

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.